

VENDIM
Nr.16, datë 10.10.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET
NR.10, DATË 9.7.2014, NR.11, DATË
1.8.2014, DHE NR.14, DATË 6.8.2014,
SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR
SHËNDETËSINË, PROJEKTET E
THIRRJES SË KATËRT, SI EDHE
SHPALLJEN E THIRRJES SË PESTË
PËR INFRASTRUKTURËN VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr.185, datë 28.12.2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën 3, që i bashkëlidhëj vendimit nr.10, datë 9.7.2014, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e fondit për art-kulturën, pyllëzime dhe gjelbërim, si edhe ujësjellës-kanalizime, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve”, bëhen ndryshime sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Në tabelën 1, që i bashkëlidhëj vendimit nr.11, datë 1.8.2014, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e Fondit për Arsimin, Fondi i Zhvillimit të Rajoneve”, bëhen ndryshime sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Në tabelën 2, që i bashkëlidhëj vendimit nr.14, datë 23.9.2014, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për një ndryshim në vendimin nr.13, datë 6.8.2014, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e fondit për infrastrukturën vendore, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve”, dhe shpërndarjen e fondit për infrastrukturën vendore, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve”, bëhen ndryshime sipas tabelës 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Shpërndarjen e fondit prej 748 359 782 (shtatëqind e dyzet e tetë milionë e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e dy) lekësh, për projektet e reja të thirrjes së katërt, për infrastrukturën vendore, sipas tabelës 4, bashkëlidhur këtij vendimi, me burim financimi, si më poshtë vijon:

a) pjesën e financimit të papërdorur, prej 118 203 724 (njëqind e tetëmbëdhjetë milionë e dyqind e tre mijë e shtatëqind e njëzet e katër) lekësh, detajuar në pikën 5, të vendimit nr.12, datë 1.8.2014;

b) pjesën e financimit të disponueshëm, prej 431 267 281 (katërqind e tridhjetë e një milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë e një) lekësh, për projektet fituese të

infrastrukturës vendore të thirrjes së katërt, sipas vendimit nr.14, datë 23.9.2014;

c) një pjesë të financimit, prej 2 570 000 000 (dy miliardë e pesëqind e shtatëdhjetë milionë) lekësh, përmes shtesës së parashikuar nëligjin nr.122/2014, datë 25.9.2014, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.1, datë 17.9.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014””. Pjesa e mbetur e këtij fondi destinohet për financimin e thirrjes së pestë për projekte, sipas pikës 6, të këtij vendimi.

5. Shpërndarjen e fondeve për projekte në fushën e shëndetësisë, në vlerën 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekë, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014, specifikuar sipas tabelës 5, bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Shpalljen e thirrjes së pestë për projektet e infrastrukturës vendore, me ndikim për zhvillimin ekonomik të rajoneve, si dhe projekte të vogla vendore, si dhe kërkesat për avancim financimi fondesh, nga financimi 2015, për objekte me ecuri punimesh dhe/ose realizim mbi financimin e 2014, me financim sipas shkronjës “c”, të pikës 2, të këtij vendimi. Procedurat e aplikimit janë të njëjta me ato të ndjekura në thirrjen e mëparshme. Kriteret e vlerësimit të projekteve përcaktohen në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Ngarkohen ministri i Kulturës, ministri i Arsimit dhe Sportit, ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit, ministri i Shëndetësisë, ministri i Financave dhe Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	Anëtar;
Ministri i Financave	Anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit	Anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	Anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	Anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	Anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	Anëtar;
Ministri i Kulturës	Anëtar;
Ministri i Mjedisit	Anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	Anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	Anëtar.

Tabela 1. Ndryshim në tabelën 3, që i bashkëlidhë vendimit nr.10, datë 9.7.2014
Projekti nr.1 dhe totali i tabelës nr.3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë projektit (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2014 (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (lekë)
QARKU KORÇË					
1	Bashkia Korçë	Qendra për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës	60,000,000	23,819,000	36,181,000
TOTALI			60,000,000	23,819,000	36,181,000

Tabela 2. Ndryshim në tabelën 1, që i bashkëlidhë vendimit nr.11, datë 1.8.2014

Projekti nr.23, i tabelës nr.2, zëvendësohet me projektet 23 dhe 24, si më poshtë vijon, ndërkohë që totali i tabelës ndryshohet, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2014 (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (lekë)
QARKU VLORË					
23	Bashkia Sarandë	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare, Gjashtë, Sarandë	46,000,000	15,000,000	31,000,000
24	Bashkia Sarandë	Ndërtimi i kopshtit në zonën e sipërme urbane	43,700,000	16,845,200	26,854,800
TOTALI			524,531,095	260,000,000	264,531,095

Tabela 3. Ndryshim në tabelën 2, që i bashkëlidhë vendimit nr.14, datë 23.9.2014

Projekti nr.6, i tabelës nr.2, si edhe totali në fund të tabelës, ndryshohen, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2014 (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (lekë)
QARKU TIRANË					
6	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksioni i rrugës Porcelan-Kinostrudio - Surrel	417,207,528	54,106,626	363,100,902
TOTALI			643,763,636	94,000,000	549,763,636

Tabela 4. Projektet e reja për infrastrukturën vendore, thirrja e katërt, për financim nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve

Nr	Autoriteti kontraktues	Titulli i Projektit	Vlera e plotë e projektit	Vlera për financim 2014	Vlera për financim 2015
		Qarku Durrës			
1	Bashkia Durrës	Rikonstruksion i rrugës "Erë Pranvere"	50,343,215	15,102,965	35,240,251
2		Rikonstruksion i rrugës "Sulejman Pitarka"	37,743,174	11,322,952	26,420,222
3		Rikonstruksion i rrugës "Porto Roman"	50,182,409	15,054,723	35,127,686
4		Rikonstruksion i rrugës "Pelumbari"	8,197,273	2,459,822	5,737,451
5		Rikonstruksion i rrugës "Durrës Ndërshekuj"	10,640,546	3,192,164	7,448,382
6		Rikonstruksion i rrugës "Tasim Këllici"	50,182,409	15,054,723	35,127,686
7		Rikonstruksion i rrugës "Juba"	50,547,553	15,164,266	35,383,287
8		Rikonstruksion i rrugës "Jezerca"	50,394,370	15,118,311	35,276,059
9		Rikonstruksion i rrugës "Rinia Durrsake"	48,105,455	14,431,637	33,673,819
10		Rikonstruksion i rrugës "Bajram Curri"	43,661,461	13,098,438	30,563,023
TOTALI			399,997,865	120,000,000	279,997,865
		Qarku Tiranë			

11	Bashkia Kavajë	Rikonstruksion i rrugës së Tërsonsve (rruga hyrëse e qytetit)	190,797,474	57,239,242	133,558,232
		Qarku Vlorë			
12	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Hartimi i projekt-ideve dhe projekteve të zbatimit për transformim dhe përmirësim të hapësirës urbane në disa zona në rajonet Tiranë-Durrës dhe Bregdetin e Jugut	96,600,000	28,980,000	67,620,000
13	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion i rrugës Çermë Sektor, Tre urat-Staravec-Gërmenj i Madh, Tre Urat-Autostradë Rrogozhin-Lushnje L=16Km (Unaza Divjakë)	425,016,000	127,504,800	297,511,200
14	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Lidhja e rrugës TransBallkanike me superstradën Fier-Vlorë	641,123,002	192,336,901	448,786,101
15	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rehabilitim i gjelbërimit anësor dhe hyrje-daljeve në qendrat e banuara në segmentin Levan-Kakavijë	156,371,379	46,911,414	109,459,965
16	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Mbushja me rërë e Plazhit Vlorë (pjesë e projektit Lungomare, Vlorë)	267,986,880	80,396,064	187,590,816
17	Bashkia Orikum	Gjelbërim, sistemim rrugore Pashë Aliman-Orikum Llogara	22,000,000	6,600,000	15,400,000
		Qarku Lushnjë-Qarku Berat			
18	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rehabilitim i gjelbërimit Anesor dhe vendqendrimëve të perkohshme segmenti rrugor Lushnje - Berat Loti 1	29,691,000	8,907,300	20,783,700
19	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rehabilitim i gjelbërimit Anesor dhe vendqendrimëve të perkohshme segmenti rrugor Lushnje - Berat Loti 2	67,829,712	20,348,914	47,480,798
20	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rehabilitim i gjelbërimit Anesor dhe vendqendrimëve të perkohshme segmenti rrugor Lushnje - Berat Loti 3	39,279,600	11,783,880	27,495,720
		Qarku Korçë			
21	Komuna Çlirim	Rruga Qafezezë - Sokole - Psari i zi	20,000,000	6,000,000	14,000,000
		Qarku Shkodër			
22	Bashkia Shkodër	Pyllëzimi i objektit Kodra e Tepes	3,876,038	1,162,811	2,713,227
23	Bashkia Shkodër	Punimet Sivikulturale në pyjet artificial	3,232,522	969,757	2,262,765
		Qarku Fier			
24	Komuna Portëz	Rruga lidhëse midis një grupi fshatrash (Mbyet, Pluk, Krraps, Lalar)	392,187,000	39,218,700	352,968,300
		TOTALI	2,755,988,472	748,359,782	2,007,628,690

Shënim

1. "Vlera e plotë e projektit" përfaqëson vlerën brenda të cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga NJQV-të)
2. "Vlera e financimit" për vitin 2014 tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014.
3. Diferenca financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2014, do të financohet nga FZHR për vitin 2015.

Tabela 5. Projektet për shëndetin parësor, për financim nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve

Autoriteti kontraktues	Titulli i projektit	Vlera e plotë projektit (lekë)	Vlera për financim 2014 (lekë)	Vlera për financim 2015 (lekë)
QARKU FIER				
Bashkia Divjakë	Ndërtimi i Qendrës Spitalore, Divjakë	52,400,000	12,195,000	40,205,000
Bashkia Divjakë	Supervizion për ndërtimin e Qendrës Shëndetësore Bashkia Divjakë	730,000	730,000	0
Bashkia Divjakë	Kolaudim për ndërtimin e Qendrës Shëndetësore Bashkia Divjakë	75,000	75,000	0
TOTALI		53,205,000	13,000,000	40,205,000

Shënim

1. “Vlera e plotë e projektit” përfaqëson vlerën brenda të cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga NJQV-të).
2. “Vlera e financimit për vitin 2014” tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014.
3. Diferenca financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2014 do të financohet nga FZHR-ja për vitin 2015.

SHTOJCA I KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

A. Kriteret e vlerësimit teknik

Këto kritere përdoren nga sekretariatet teknike për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet vlerësimi, maksimalisht, me 70 pikë i një projekti.

Kriteret 1 dhe 2 detajohen në nënkriteret përkatëse teknike, nga sekretariati teknik për projektet e infrastrukturës vendore, i ngritur pranë ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Kriteret teknike për vlerësimin e projekteve janë, si më poshtë vijon:

1. Cilësia teknike dhe kostimi, vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore. Ky kriter nënkupton se projektet, që teknikisht janë detajuar saktë dhe qartë, si dhe ato projekte, ku kostimi i projektit dhe preventivi është përpiluar dhe vlerësuar saktë nga aplikanti, me çmimet referencë sipas buletineve etj., do të vlerësohen për financim, duke pasur një vlerësim nga 0 deri në, maksimalisht, 25 pikë.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit, si pjesë e sekretariatit teknik, ngarkohet të kryejë rishikimin financiar të kostimit dhe preventivave të projekteve me potencial të paraqitura nga aplikantët, sipas buletineve të çmimeve, kostove referencë etj., si dhe të përgatitë raportin e vlerësimit financiar të tyre e rekomandimet përkatëse.

2. Nivel i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi rriskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike. Ky kriter vlerësohet me 0 deri në, maksimalisht, 10 pikë.

3. Ndikimi i projektit, që vlerësohet me 0 deri në, maksimalisht, 10 pikë, sipas komponentëve, si më poshtë vijon:

a) prek qendërqarkun dhe ndikon në zhvillimin ekonomive vendore, konsolidimin e strukturës ekonomike të zonave apo qarqeve të ndryshme. Për këtë komponent vlerësimi përfshin 0 deri 5

pikë.

b) ka rëndësi të veçantë nga pikëpamja turistike dhe potenciale për ekonomi lokale dhe zona të përmirësuara biznesi. Për këtë komponent, vlerësimi bëhet me 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.

c) rivitalizimi dhe rikualifikimi urban, ku synohet përmirësimi në qendra të mëdha urbane, përmes nxitjes së bërthamave social-kulturore, të shërbimeve publike, të trashëgimisë kulturore etj. Për këtë komponent, vlerësimi bëhet me 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.

ç) projekti ndikon në rehabilitimin mjedisor dhe krijimin e korridoreve të gjelbër ndërqytetas, si dhe në zona turistike. Për këtë komponent vlerësimi bëhet me 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.

4. Qëndrueshmëria e investimit nga projekti, që lidhet me faktin nëse janë parashikuar kosto mirëmbajtjeje për projektin në vazhdimësi, të cilat do të merren përsipër nga institucioni aplikues. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet me 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.

B. Kriteret e vlerësimit strategjik

Këto kriteret përdoren nga sekretariati i përgjithshëm për të kryer vlerësimin e projektit nga pikëpamja e të qenit projekt prioritar, në nivel vendor, qarku apo kombëtar, duke vlerësuar një projekt me, maksimalisht, 30 pikë, si më poshtë vijon:

1. Shkalla e përputhshmërisë me përparësitë/strategjitë vendore dhe/ose të zhvillimit të nivelit rajonal/kombëtar dhe ndikimi në zhvillimin lokal/rajonar/kombëtar. Niveli i potencialit për nxitjen e ekonomive lokale dhe zona të përmirësuara të biznesit; krijimi i poleve të zhvillimit urban të qëndërqarqeve. Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në, maksimalisht, 15 pikë.

2. Potenciali për zhvillim, qëndrueshmëri dhe për tërheqjen për investime të reja dhe/apo faza të reja të zhvillimit që paraqet projekti. Niveli i ndikimit për zhvillimin e qëndrueshëm në mjedis. Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në, maksimalisht, 15 pikë.